



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 32.
Prishtinë, më 24.02.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic dhe Etem Arifi.

Munguan: Mufera Sinik dhe Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Elita Vokshi, Florina Shala përfaqësuesi nga zyra e ICO-së Dejan Cosic, përfaqësuesi nga zyra e KDI-së Shkumbim Beqiri, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: zyrtare e lartë e fushës, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-89 për Deminim humanitar, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë votash, me një të përmbajtur, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 24.01.2012, 31.01.2012 dhe 6.02.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.

Kryesuesi, theksoi se komisioni ka paqartësi në lidhur me amendamentin 1 të propozuar nga Qeveria, nga se kërkohet që të harmonizohet versioni në gjuhën serbe me atë të gjuhës shqipe.

Ai dha sqarim se komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe amendamenteve të propozuara të Qeverisë, është bazuar në versionin në gjuhën serbe.

Në fjalinë e tij tha se për këtë takim është ftuar përfaqësuesi i Qeverisë për të dhënë sqarime adekuate në propozim amendamentin 1. të Qeverisë.

Në mungesë të përfaqësuesit të Qeverisë, kryesuesi propozoi që mbledhja e komisionit të caktohet për javën e ardhshme me të vetmen pikë e rendit të ditës: Shqyrtimi i amendamenteve të Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe.

Elmi Reçica – theksoi se lidhur me këtë projektligj, ka pas mjaftë divergjenca - dallime gjatë shqyrtim amendamenteve nga komisioni funksional dhe amendamenteve të Qeverisë.

Në kuadër të takimit të përbashkët me dy komisionet dhe takimit me dy kryetarët dhe zëvendëskryesuesit e komisioneve, janë përafuar qëndrimet tona ndërsa ka mbet kontestues harmonizimi i amendamenti 1, (nenit 4) të Qeverisë.

Gjithashtu kemi pas takime konstruktive edhe me përfaqësuesit e ICO-së, të zyrës amerikane të cilët kanë qenë të involvura në këtë ligj dhe se të njëjtit kanë dhanë përkrahjen e tyre profesionale.

Ishte i mendimit që në komision të ftohet sponsoruesit të Projektligjit gjegjësisht përfaqësuesi i MMPH për të marr opinionet e tyre lidhur me çështjen e përbërjes dhe përfaqësimit të Këshillit, në interes të fshatit Hoçë e Madhe.

Petar Miletic- në fjalinë e tij tha se Komisioni në procedurë të rregullt i ka shqyrtuar amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional dhe se të njëjtat nuk janë përkrahur ndërsa komisioni i ka miratuar amendamentet e propozuara të Qeverisë, në tërësi.

Pajtohet me parafolësit që të ftohet përfaqësuesi i Ministrisë **resore- përkatëse** lidhur me propozim amendamentin 1, të Qeverisë, nga se përfundimisht duhet të definohet versioni në gjuhën serbe me atë në gjuhën shqipe.

Kryesuesi konstatoi se pas diskutimeve të shumta lidhur me propozim amendamentet e Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, me shumicë votash dhe një të përmbajtur nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Komunitete dhe Kthim me datën 28.02.2012, në ora 13.00 do të ftojë të merr pjesë ministrin e MMPH z. Dardan Gashi, me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme, këshillimeve dhe sugjerimeve lidhur me propozim amendamentet e tyre, dhe më pas komisioni do të dalë me qëndrime konkrete.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media**, të propozuara nga Komisioni Funksional.

Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Petar Miletic- behet fjalë për një ligj shumë të rëndësishëm sa i përket komunitetit jo shumicë.

Ai theksoi se projektligji si tërësi nuk prek dhe nuk cenon të drejtat e komuniteteve.

E njoftoi komisionin se me këtë projektligj parashihet që bordi i Komisionit të pavarur për media duhet të zgjedhë dy përfaqësues të komunitetit jo shumicë. Gjegjësisht Komisioni i pavarur për media që tri vite punon në kundërshtim me ligjin nga se bordi nuk ka zgjedhur dy përfaqësues të komunitetit jo shumicë.

Ai shprehu qëndrimin e tij se ka vërejtje në Projektligj si dhe në amendamentet e komisionit funksional, andaj vërejtjet në çështjet e lartë përmendura do ti parqet në adresën e duhur

Pas diskutimeve të shumta, Kryesuesi konstatoi se Komisioni votojë amendamentet e Komisionit funksional dhe me shumicë votash dhe një të përmbajtur, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr 04/ L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet në shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit **nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit **nr. 04/L-84 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-89 për Deminim humanitar, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin **04/L-89 për Dënimin humanitar**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin **04/L-89 për Dënimin humanitar** dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic